



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 202

Tiranë – E mërkurë, 22 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 109/2017, datë 17.11.2017	Për emërimin e një anëtari të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)..... 10559
Vendim i Kuvendit nr. 110/2017, datë 17.11.2017	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 10559
Vendim i Kuvendit nr. 111/2017, datë 17.11.2017	Për caktimin e Kryetarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 10559
Urdhër i Kuvendit nr. 1, datë 22. 11.2017	Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi..... 10559
Dekret i Presidentit nr. 10641, datë 14.11.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 10561
Dekret i Presidentit nr. 10642, datë 14.11.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 10561
Dekret i Presidentit nr. 10643, datë 14.11.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 10561
Dekret i Presidentit nr. 10644, datë 14.11.2017	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10562
Dekret i Presidentit nr. 10645, datë 14.11.2017	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10562
Dekret i Presidentit nr. 10654, datë 16.11.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 10562
Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 384, datë 20.11.2017	Për delegim kompetencash..... 10563

Kërkesë e Ministrisë
së Infrastrukturës dhe Energjisë
nr. 1486/1, datë 21.11.2017

Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë
private, që preken nga realizimi i projektit “Rishikim i kalimeve
këmbësore (trotuar) dhe i hapësirave publike në rrugën “Gjykatë -
Akademia e Marinës - 7 pallatet”, faza I”, Vlorë.....

10563

**VENDIM**
Nr. 109/2017**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË
BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR
TË ENERGJISË (ERE)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Eriola Sadushi emërohet anëtare e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi në datën 21.12.2017.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 17.11.2017

VENDIM
Nr. 110/2017**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 114, pika 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Ilir Zela zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 17.11.2017

VENDIM
Nr. 111/2017**PËR CAKTIMIN E KRYETARIT TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 114, pika 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Ilir Zela caktohet Kryetar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 17.11.2017

URDHËR
Nr. 1, datë 22.11.2017**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
DHE RREGULLAVE TË HEDHJES SË
SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E
ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË
EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 149/d, dhe pikës 11, të nenit 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 284, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

URDHËROJ:

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR
ORGANIZIMIN E PROCEDURËS SË
HEDHJES SË SHORTIT

1. Miratimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

2. Hedhja e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i nënshtrohet primeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të këtij procesi.



3. Për organizimin e procedurave të hedhjes së shortit dhe dokumentimin e çdo faze të saj krijohet një Sekretariat Teknik. Numri i anëtarëve dhe përbërja e Sekretariatit Teknik caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë.

4. Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë cakton datën dhe orën e organizimit të shortit.

Data dhe ora e organizimit të shortit publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

5. Kryetari i Kuvendit njofton zyrtarisht për datën dhe orën e organizimit të shortit Prokurorin e Përgjithshëm, Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarin e Gjykatës së Lartë dhe Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, të cilët ftohen të dërgojnë përfaqësuesit e tyre për të qenë prezentë në organizimin e shortit.

Përfaqësuesit e këtyre institucioneve të caktuar për të marrë pjesë në organizimin e shortit nuk duhet të jenë të njëjtë me personat e përfshirë në listën e kandidatëve të paraqitur për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

6. Për zhvillimin e procedurës së hedhjes së shortit njoftohet dhe ftohet të marrë pjesë si vëzhgues: Avokati i Popullit, përfaqësues të grupeve parlamentare, përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, organizata partnere ndërkombëtare dhe media.

7. Në datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit, Sekretariati Teknik sigurohet paraprakisht për praninë e:

a) përfaqësuesve të dërguar nga institucionet e përcaktuara nga neni 284 i ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;

b) Avokatit të Popullit ose të përfaqësuesit të autorizuar prej tij;

c) Përfaqësuesve të grupeve parlamentare, të përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë dhe të organizatave partnere ndërkombëtare, në cilësinë e vëzhguesve; dhe i fton ata të zënë vendet e caktuara.

8. Mosparaqitja e përfaqësuesve të institucioneve të përcaktuara nga neni 284 i ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” nuk pezullon procedurat e hedhjes së shortit.

KREU II

PROCESI I HEDHJES SË SHORTIT

9. Shorti organizohet në dy kuti transparente. Në njërën prej kutive vendosen goglat dhe në kutinë tjetër vendosen shiritat e letrës, ku janë

shënuar emrat e kandidatëve të propozuar nga secili institucion sipas listës së përcjellë Kuvendit të Shqipërisë.

10. Shiritat e letrës me emrat e kandidatëve futen në gogla. Numri i goglave duhet të përputhet me numrin e kandidatëve të propozuar nga secili institucion, sipas listës së përcjellë Kuvendit të Shqipërisë.

11. Radha e futjes së goglave në kuti dhe radha e hedhjes së shortit përcaktohet duke u mbështetur në renditjen e mëposhtme:

a) kandidatë të Gjykatës Kushtetuese;

b) kandidatë të Gjykatës së Lartë;

c) kandidatë nga Prokuroria e Përgjithshme;

ç) kandidatë nga gjykatat e apelit;

d) kandidatë nga zyrat e prokurorisë pranë gjykatave të apelit;

dh) kandidatë nga gjykatat administrative.

12. Një nga anëtarët e Sekretariatit Teknik, i ndryshëm nga anëtari që fut shiritin e letrës në gogël, tërheq nga kutia përkatëse me radhë goglat.

Anëtari i Sekretarit Teknik pasi e hap goglën, e lexon me zë të lartë emrin e kandidatit për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, që është i shënuar në të dhe ia tregon të gjithë pjesëmarrësve.

Shiriti i letrës që gjendet brenda saj, i dorëzohet Sekretariatit Teknik.

13. Kandidati, emri i të cilit është shënuar në shiritin e letrës, do të jetë anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

14. Me të njëjtin short dhe të njëjtën procedurë, të parashikuar nga pikat 9 deri në 13 të këtij urdhri, zgjidhet edhe një anëtar zëvendësues nga secili institucion sipas parashikimeve të pikës 7, të nenit 221, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

15. Pas tërheqjes së goglave nga anëtari i Sekretariatit Teknik, kutia transparente zbrazet dhe në të futen goglat me emrat e kandidatëve të dërguar nga institucioni tjetër sipas radhës së caktuar në pikën 11 të këtij urdhri.

16. Rezultati i shortit shpallet nga Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë.

17. Procedura e hedhjes së shortit regjistrohet në audio dhe video.

18. Për dokumentimin e çdo faze të procedurës së organizimit dhe hedhjes së shortit sipas parashikimeve të këtij urdhri mbahet procesverbal.



19. Rezultatet e shortit së bashku me një relacion për procesin e organizimit të shortit bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

20. Avokati i Popullit bën menjëherë publik në faqen zyrtare të institucionit raportin e monitorimit të procesit të shortit.

21. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe Sekretariati Teknik për ndjekjen e procedurave të nevojshme të zbatimit të këtij urdhri.

22. Vendimi nr. 3, datë 24.1.2017, “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

DEKRET

Nr. 10641, datë 14.11.2017

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministres së Kulturës,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Mentor Zenun Zymberaj
2. Florentina Fehim Baraku (Efendija)
3. Hana Vetton Bajrami Rexhepi (Bajrami)
4. Arlinda Mustafa Selimi (Ramadani)
5. Astrit Mustafë Ibrahim
6. Ilir Heset Tafa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 10642, datë 14.11.2017

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 9, 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Lumturije Nebi Shehaj (Gjondedaj)
2. Lindita Mersel Felahi (Dema/Häusler)
3. Frosina Niko Prendi (Beja)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 10643, datë 14.11.2017

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministres së Kulturës dhe ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Mimoza Avni Hamidi
2. Shpresa Gjafer Aradini
3. Kristina Maureen Marjan Maksuti
4. Agon Fatmir Mucolli
5. Agon Blerim Husejini



6. Gani Rexhë Mehmetaj
7. Shpat Faton Deda

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 10644, datë 14.11.2017

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Merita Reshit Zerr (Ipeku)
2. Ysnije Maliq Alaj (Havolli)
3. Olgenita Dritan Alaj
4. Spiro Pjetron Matanoviq (Pjetri)
5. Blerina Hidajet Gjokutaj-Kapaj (Gjokutaj)
6. Melisa Hari Kapaj
7. Merita Hari Kapaj
8. Krenar Kosta Bollguri
9. Laura Maksim Otten (Kolli)
10. Dritan Mikail Lluka
11. Valbona Kujtim Lluka (Çuçalla)
12. Fisnik Fahri Kraja
13. Fjoralba Festim Kraja (Spaho)
14. Iris Fisnik Kraja
15. Pirro Luboja Matanoviq
16. Leida Vladimir Matanoviq (Nikollaj)
17. Lorela Rifat Bllakçori
18. Eduart Xhemali Llazaridhis (Ibrahimi)
19. Andi Ymer Bimi
20. Elona Daut Zeqiri (Kasneci)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 10645, datë 14.11.2017

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Desdemonë Kujtim Çepele
2. Klaus Vasil Biri
3. Arkelon Qerim Hita
4. Amarilda Yzeir Dhanda (Allaraj)
5. Klajvert Anton Gjera
6. Sokol Çlirim Miller (Osmani)
7. Bresida Xhemali (Isa) Mebelli (Gjura)
8. Ajtanka Kristaq Heinzer (Bërxholi)
9. Xhezo Ardian Veshi
10. Tenald Naim Zaçe (Zace)
11. Ardit Bexhet Haxhiaj
12. Maniola Vangjel Kiechle (Mile)
13. Chris Johannes Xhovan Çohadari
14. Enida Muhamet Kapllani
15. Stela Dhimitraq Moçka
16. Eriselda Thoma Gallo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 10654, datë 16.11.2017

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së



Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Fatos Hanis Mustafa
2. Luljeta Abdulhakim Mustafa (Menga)
3. Qëndrim (Çendrim) Shai Rijani
4. Ilir Muharrem Gjocaj
5. Alketa Agron Rragami (Ahmetaj)
6. Sylë Shiqeri Ukshini

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**URDHËR
Nr. 384 datë 20.11.2017**

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për Arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Arben Dervishllari, Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 21.11.2017 deri në datën 24.11.2017.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore të iniciuara apo

përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Arben Dervishllari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dr. Ardit Bido**

**KËRKESË
Nr. 1486/1, datë 21.11.2017**

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rishikim i kalimeve këmbësore (trotuar) dhe i hapësirave publike në rrugën “Gjykatë - Akademia e Marinës - 7 pallatet”, faza I”, Vlorë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për llogaritjen e vlerës së truallit, si dhe masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listave emërore “shtojca 1” dhe “shtojca 2”, bashkëlidhur.

Vlera e shpronësimit është (35,659,469 + 40,715,070) lekë, gjithsej 76,374,539 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli**



Shtojca 1

Tabela me listën e pronarëve të pasurive pronë private dhe vlerat e shpronësimit, për realizimin e projektit:
Rishikim i kalimeve këmbësore (trotuare) dhe i hapësirave publike në rrugën “Akademia e Marinës - 7 pallatet”

Çmimi i truallit sipas VKM-së 89, datë 3.2.2016,
Çmimi për objektet sipas VKM-së 138, datë 23.3.2000, dhe udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, i EKB Tiranë

NR.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe trualli	Çmimi i truallit Lekë/m ²	Vlera e truallit Lekë	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i ndërtimit Lekë/m ²	Vlera e ndërtimit Lekë	Vlera totale Truall dhe ndërtësë	Shënime
Rishikim i kalimeve këmbësore (trotuare) dhe i hapësirave publike në segmentin “Akademia e Marinës - 7 pallatet”												
1	8602	39/245	Vlorë	Mbivendosje	12.56	10903	136,942				136,942	Kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e mbivendosjes.
2	8602	39/265	Vlorë	Bernard dhe Eduard Caushaj	148.2	10903	1,615,825				1,615,825	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Ka 2 ndërtime pa leje.
3	8602	39/266	Vlorë	Jovan Jaupaj	11.22	10903	122,332				122,332	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
4	8602	38/155	Vlorë	S'ka informacion	15.5	10903	168,997				168,997	Saktësim dokumentacioni.
5	8602	38/154	Vlorë	S'ka informacion	12	10903	130,836				130,836	Saktësim dokumentacioni.
6	8602	38/88	Vlorë	Taulla Zanaj	9.16	10903	99,871				99,871	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
7	8602	38/156	Vlorë	S'ka informacion	83	10903	904,949				904,949	Saktësim dokumentacioni.
8	8602	38/49	Vlorë	mbivendosje	334.5	10903	3,647,054				3,647,054	Kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e mbivendosjes.
9	8602	36/42/2	Vlorë	BP Hoxha, Toshi, Bedini, Velaj BP (8)	16.7	204	3,407				3,407	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Lloji i pronës ullishte.
10	8602	36/164	Vlorë	Sazan Hoxha	4.88	10903	53,207				53,207	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
11	8602	36/162	Vlorë	Sazan Hoxha	12	10903	130,836				130,836	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
12	8602	36/43/1	Vlorë	S'ka informacion	15.72	10903	171,395				171,395	Saktësim dokumentacioni.
13	8602	36/41	Vlorë	Mbivendosje	39.73	10903	433,176				433,176	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e mbivendosjes.
14	8602	36/222	Vlorë	Gezim, Ilir dhe Safete Sadiku	9.12	10903	99,435				99,435	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Kufizim veprimesh deri në saktësim skice dhe hipotekuar në favor të Union Bank.
15	8602	36/10	Vlorë	Mbivendosje	16.7	10903	182,080.10				182,080	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Kufizim veprimesh deri në zgjidhjen e mbivendosjes.
16	8602	35/101	Vlorë	Mikel Caushi	20.3	10903	221,330.90				221,331	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Mbi këtë pasuri është dhënë AMTP në emër të M. Aliaj dhe ka 3 nd. pa leje.



17	8602	35/73/2	Vlorë	BP (18)	50.5	10903	550,602				550,602	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Kontratë sipërmarrje.
18	8602	35/144	Vlorë	BP Jazaj, Shehu, Vaja, Sina etj. (45)	21	10903	228,963				228,963	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Kontratë sipërmarrje.
19	8602	35/122	Vlorë	Perlat dhe Rrufe Lushaj	396.7	10903	4,325,220				4,325,220	Saktësim dokumentacioni. Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Kontratë sipërmarrje. Mbi këtë pasuri ndodhet pasuria 35/52-nd. Objekti i shkollës së Marinës.
20	8602	35/167	Vlorë	Albana, Altin dhe Vitore Licaj	61.3	10903	668,354				668,354	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
21	8602	35/168	Vlorë	S'ka informacion	7	10903	76,321				76,321	Saktësim dokumentacioni.
22	8602	36/11	Vlorë	S'ka informacion	2.47	10903	26,930				26,930	Saktësim dokumentacioni.
23	8602	36/40	Vlorë	BP Luzaj	29	10903	316,187				316,187	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
24	8602	36/247	Vlorë	S'ka informacion	17.4	10903	189,712				189,712	Saktësim dokumentacioni.
25	8602	36/175	Vlorë	Razie shehu	24.4	10903	266,033				266,033	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
26	8602	36/267	Vlorë	Hektor Hajro	23	10903	250,769				250,769	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
27	8602	36/117/3	Vlorë	S'ka informacion	23.5	10903	256,221				256,221	Saktësim dokumentacioni.
28	8602	36/117/6	Vlorë	S'ka informacion	18.2	10903	198,435				198,435	Saktësim dokumentacioni.
29	8602	36/119	Vlorë	BP SHEHAJ	204.5	10903	2,229,664				2,229,664	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
30	8602	36/103	Vlorë	S'ka informacion	691	10903	7,533,973				7,533,973	Saktësim dokumentacioni. S'ka informacion.
31	8602	36/278	Vlorë	S'ka informacion	55	10903	599,665				599,665	Saktësim dokumentacioni. S'ka informacion.
32	8602	36/182	Vlorë	BP Opingari, Mustafaraj, Resuli Llohja	1684.5	204	343,638				343,638	Konfirmuar nga ZVRPP. Tokë arë. Sekuestro konservative.
33	8602	36/196	Vlorë	S'ka informacion	209	10903	2,278,727				2,278,727	Saktësim dokumentacioni.
34	8602	36/194	Vlorë	Faslli Hajro	101.75	10903	1,109,380				1,109,380	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Diferencë sipërfaqeje.
35	8602	36/99	Vlorë	Myqerem Hamzaraj	317.5	204	64,770				64,770	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Kufizim veprimesh deri në saktësimin e skicës. Lloji i pronës Pemëtore
36	8602	36/89	Vlorë	BP Vokopola	281.26	10903	3,066,578				3,066,578	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Ka 2 nd. pa leje.
37	8602	36/280	Vlorë	S'ka informacion	37.5	10903	408,863				408,863	Saktësim dokumentacioni.
38	8602	36/281	Vlorë	S'ka informacion	38.5	10903	419,766				419,766	Saktësim dokumentacioni.
39	8602	36/250	Vlorë	S'ka informacion	4.5	10903	49,064				49,064	Saktësim dokumentacioni.
40	8602	36/295	Vlorë	Shkelqim Agalliu	190.77	10903	2,079,965				2,079,965	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
											35,659,469	



Shtojca 2

Tabela me listën e pronarëve të pasurive pronë private dhe vlerat e shpronësimit, për realizimin e projektit:
Rishikim i kalimeve këmbësore (trotuare) dhe i hapësirave publike në rrugën “Gjykatë - Akademia e Marinës”

Çmimi i truallit sipas VKM-së 89, datë 3.2.2016
Çmimi për objektet sipas VKM-së 138, datë 23.3.2000, dhe udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016 i EKB Tiranë

NR.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe trualli m ²	Çmimi i truallit Lekë/m ²	Vlera e truallit Lekë	Sipërfaqe ndërtimi m ²	Çmimi i ndërtimit Lekë/m ²	Vlera e ndërtimit Lekë	Vlera totale Truall dhe Ndërtesë Lekë	Shënime
Rishikim i kalimeve këmbësore (trotuare) dhe i hapësirave publike në segmentin “Gjykatë - Akademia e Marinës”												
1	8602	2./33	Vlorë	S'ka informacion	925.5	10903	10,090,727				10,090,727	Saktësim dokumentacioni
2	8602	3/51.	Vlorë	S'ka informacion	27.3	10903	297,652				297,652	Saktësim dokumentacioni
3	8602	3./47	Vlorë	S'ka informacion	197.8	10903	2,156,613				2,156,613	Saktësim dokumentacioni
4	8602	3/70.	Vlorë	S'ka informacion	110	10903	1,199,330				1,199,330	Saktësim dokumentacioni
5	8602	3/22-ND	Vlorë	S'ka informacion	0	10903	0	63.5			0	Saktësim dokumentacioni. Prona është ngrirë
6	8602	3/54.	Vlorë	Kastriot Tafili, Bukurie Tafili	170	10903	1,853,510				1,853,510	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
7	8602	3/45.	Vlorë	Jani Murataj	180	10903	1,962,540				1,962,540	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Saktësim dokumentacioni
8	8602	3/71.	Vlorë	S'ka informacion	26.6	10903	290,020				290,020	Saktësim dokumentacioni
9	8602	3/65.	Vlorë	S'ka informacion	158	10903	1,722,674				1,722,674	Saktësim dokumentacioni
10	8602	3/26.	Vlorë	S'ka informacion	65	10903	708,695				708,695	Saktësim dokumentacioni
11	8602	3/26-ND	Vlorë	S'ka informacion		10903	0	65			0	Saktësim dokumentacioni
12	8602	3/19.	Vlorë	Nasho Risilia	221.7	10903	2,417,195				2,417,195	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
13	8602	14/326	Vlorë	Artur Alikaj	50.5	10903	550,602				550,602	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
14	8602	14/311	Vlorë	Thoma Nondo	41.25	10903	449,749				449,749	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Hipotekohet banka e parë e investimeve.
15	8602	14/299/1	Vlorë	S'ka informacion	223.5	10903	2,436,820.50				2,436,821	Saktësim dokumentacioni
16	8602	14/329	Vlorë	S'ka informacion	20	10903	218,060.00				218,060	Saktësim dokumentacioni
17	8602	20/170	Vlorë	Sadik Beqiri	54.13	10903	590,179.39				590,179	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
18	8602	20/168	Vlorë	S'ka informacion	184	10903	2,006,152				2,006,152	Saktësim dokumentacioni
19	8602	29/34-T	Vlorë	Fatmir Alikaj	32	10903	348,896				348,896	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
20	8602	29/34-ND	Vlorë	Fatmir Alikaj	32	10903	348,896				348,896	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
21	8602	29/135	Vlorë	bp Bezhani	79.7	10903	868,969				868,969	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
22	8602	29/40	Vlore	S'ka informacion	42	10903	457,926				457,926	Saktësim dokumentacioni.
23	8602	29/96	Vlorë	BP Fallanaj, Beqaj etj.	99	10903	1,079,397				1,079,397	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.



24	8602	21/122	Vlorë	S'ka informacion	1.5	10903	16,355				16,355	Saktësim dokumentacioni
25	8602	21/171	Vlorë	Luçjana Gamaj	10.7	10903	116,662				116,662	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
26	8602	21/170	Vlorë	Adelina Hasanaj	12	10903	130,836				130,836	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
27	8602	21/149	Vlorë	Ariel Meçaj	24	10903	261,672				261,672	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
28	8602	21/147	Vlorë	Engjeni Doko	14.8	10903	161,364				161,364	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
29	8602	21/144	Vlorë	Izet Kabashaj	24.4	10903	266,033				266,033	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
30	8602	21/142	Vlorë	Ismet Brokaj	43.6	10903	475,371				475,371	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
31	8602	15/133	Vlorë	18 BP Bashkëpronësi Dervishi	18	10903	196,254				196,254	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
32	8602	14/304	Vlorë	Nevila Karafili	7.2	10903	78,502				78,502	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
33	8602	14/303	Vlorë	S'ka informacion	54.5	204	11,118				11,118	Saktësim dokumentacioni
34	8602	14/302	Vlorë	BP 18	43.7	10903	476,461				476,461	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Ndodhet ndërtesa me nr. pasurie 14/97 -ND1
35	8602	14/216	Vlorë	BP 18	9	10903	98,127				98,127	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
36	8602	14/226	Vlorë	18 BP Bashkëpronësi Dervishi	400	10903	4,361,200				4,361,200	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Kufizim me vendim gjyqate
37	8601	34/18	Vlorë	S'ka informacion	81.4	10903	887,504				887,504	Saktësim dokumentacioni
38	8601	28/285	Vlorë	Janul Çuka	18.00	10903	196,254				196,254	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
39	8601	28/283	Vlorë	Janul Çuka	85	10903	926,755				926,755	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë.
											40,715,070	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë